



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2130/8 prot.

Datë 20.09.2023

V E N D I M

Nr. 942/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Health & Light” SHPK me NIPT L42231011L dhe adresë: Rruga “Themistokli Germenji” Nd.11, H.4, Ap.4, njësia Administrative Nr.2, 1010, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Spitali Universitar i Traumës me adresë: Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë
- Subjekti i interesuar:** Operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK me NIPT K31520054N dhe adresë: Bulevardi “Bajram Curri” SHPK, pallati Kastrati, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 08.08.2023 është zhvilluar procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton, se në datën 21.08.2023, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. “Health & Light” SHPK	8,300,000 lekë	skualifikuar
2. “O.E.S DISTRIMED ” SHPK	9,500,000 lekë	kualifikuar
3. “BIOMETRIC ALBANIA ” SHPK	10,870,000 lekë	kualifikuar
4. “T R I M E D” SHPK	13,789,000 lekë	skualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se:

OE Nuk Ploteson kriterin 2.3 Kapaciteti Teknik: 2.3.6 Për të gjithë artikujt e kerkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) te paraqiten katalogë, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogët do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

Konkretisht për Artikullin Nr.4 - Shtrat operacioni ortopedike Baza te jete celik inox 304 - specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed materiali per shtratin ortopedik eshte ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallen e kualitetit te celik inoksit 304. Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5cm. Set me jastike silikon rrethore per koken, 4 permasa – Iset, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar.

Për Artikullin Nr.5 - Shtrat operacioni për neurokirurgji Baza te jete celik inox 304 - specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed materiali per shtratin ortopedik eshte ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallen e kualitetit te celik inoksit 304. Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5cm. Fiksuesi kranial te kete referencen optike per neuronavigator, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun e paraqitur Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed mungon referenca optike per neuronavigator. Reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikular me montim ne fiksuesin kranial -Icope, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi nuk eshte ofruar aksesori reference optike si dhe krahu i artikular per montim ne fiksuesin kranial. Ne katalogun Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese

Huidamed eshte markuar artikulli "Navigation adaptor me kod HR07021G" qe nuk ploteson kerkesen as per referencen optike dhe as per krahun e artikuluar sic jane kerkuar. Set me jastike silikon rrethore per koken, 4 permasa - Iset, specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar."

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 30.08.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3387 dhe me nr. 2130/2023 prot., datë 30.08.2023 e operatorit ekonomik "Health & Light" SHPK, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2130/2 datë 31.08.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit.

II.6. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 24.08.2023 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në SPE.

II.7. Me datën 04.09.2023 protokolluar me tonën me nr.2130/3 prot., operatori ekonomik "O.E.S Distrimed" SHPK ka paraqitur formularin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të LPP-së, duke respektuar afatet ligjore të paraqitjes së tyre.

II.8. Me shkresën nr. 2261/1 prot, datë 06.09.2023 me objekt: "Vendim për Ankesën nr: A/2023/3387 datë 30-08-2023" protokolluar me tonën me nr. 2130/4 datë 06.09.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Health & Light" SHPK. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit ka argumentuar se:

"Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave:

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe dokumentacionit të paraqitur ne SPE, Arsyeton: Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 16272020, "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, DST-së, si dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, KSHA, gjykon se:

Nga shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimues konstatohet, se nga ana e tij nuk parashtrohen fakte apo argumente të bazuara, por ngrihen pretendime a-priori dhe të përgjithshme në lidhje me specifikimet teknike te ofruara.

Nga verifikimi i dokumentacionit te publikuar ne SPE, Aneksi nr.5 (Specifikimet Teknike), rezulton se AK ka hartuar specifikimet teknike konform Nenit 36 te Ligjit 16272020 "Për Prokurimin Publik" duke mos përdorur asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces

te veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalent”.

Vlen të theksohet gjithashtu fakti se në këtë procedurë prokurimi bazuar në ankesën e një OE dhe në vendimin e KPP-së me Nr. 662/2023 Prot., datë 24.07.2023, AK me anë të shtojcës Nr. 1 ka kryer modifikimin e dokumenteve të tenderit.

OE ankimes “Health & Light” SHPK nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për sqarim apo ankesë para fazës së zhvillimit të procedurës siç parashikon ligji.

1. Lidhur me pretendimin nr. 1 të ankimesit për arsyen e skualifikimit si më poshtë:

Për Artikullin Nr.4 dhe Nr.5 Shtratë operacioni ortopedike Baza të jete celik inox 304.

-specifikimi i kërkuar nuk plotësohet pasi në katalogun Kataloge të perkthyer Infimed të firmës prodhuese Infimed materiali për shtratin ortopedik është ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallën e kualitetit të celik inoksit 304.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i dokumentacionit të paraqitur në SPE, KSHA konstaton se OE “Health 4: Light” SHPK argumenton dhe pranon faktin që specifikimi i kualitetit të celik inoksit 304 nuk është pasqyruar në katalogun e paraqitur në SPE. OE jo vetëm që nuk paraqet fakte apo argumente të reja provuese ku të mbështesë pretendimin e tij se ky specifikim plotësohet, por kërkon që AK të mbledhë fakte dhe prova për të kuptuar që ky specifikim plotësohet.

AK kërkon sqarime kur është e nevojshme mbi dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe nuk mund të kërkojë dokumente shtese për Operatoret Ekonomik pasi është detyrim ligjor i Operatoreve Ekonomik që të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KSHA gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimesi jo vetëm që duhet të shprehej se: “Gjithsesi nga prodhuesi kemi konfirmimin që materiali i përdorur është AISI304” por duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij.

KVO ka vlerësuar ofertën në përputhje me Nenin 92, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ku përcaktohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”

KSHA gjykon se KVO ka vepruar drejt pasi, për të bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura, KVO-ja bazohet në dokumentet dhe katalogët e paraqitur në SPE dhe rezulton se nuk ka asnjë referencë për sa i përket gradës së çelikut inoks.

Për më tepër OE duke qenë në dijeni se, citojmë: Në katalogun e kompanisë përmendet të materiali është celik inoks por kompania nuk e ka konsideruar të domosdoshëm specifikimin e numrit të gradës, duhet të merrte masa për të marrë më shumë informacion nga kompania prodhuese mbi gradën e çelikut inoks dhe kjo të pasqyrohej në katalogun e paraqitur në SPE.

Specifikimi i gradës 304 të çelikut inoks është një element i rëndësishëm për të përcaktuar cilësinë e bazës së shtratit operator dhe mos përcaktimi i këtij kriteri në katalogun e paraqitur në SPE mund të sjellë pabarazi midis OE konkurrues. Mos përcaktimi i gradës së çelikut inoks mund të lëri hapësira për përdorimin e inoksit me gradë më të ulët së kërkesa e AK duke ulur kostot në mënyrë të padrejtë për OE ankimues.

Pavarësisht kësaj, edhe nëse OE ankimues nuk do të mundej të përcaktonte gradën e çelikut inoks (ose do të ishte më e ulët se kërkesat e AK) pasi sipas OE ankimues deklaron, citojmë: Natyrisht kur një kompani prodhuese përgatit katalogët e saj i përgatit për të gjithë botën dhe jo enkas për procedurën tuaj të prokurimit, mund të kishte ushtruar të drejtën e tij të ankimimit për dokumentet e tenderit sipas afateve të përcaktuara në Nenin 110, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Neni 2, pika d, i ligjit nr. 162/2020 Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Nëse ankesa do të pranohej, AK të njoftonte të gjithë OE se do pranoheshin variante me cilësi më të ulëta se grada 304 duke garantuar një konkurrencë të ndershme midis OE, **por jo në këtë fazë të procedurës.**

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK NUK qëndron.

2. Lidhur me pretendimin nr. 2 te ankimuesit për arsyen e skualifikimit si me poshtë:

Për Artikullin Nr.4 dhe Nr. 5 - Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit.

-Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5 cm.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i dokumentacionit të paraqitur në SPE, KSHA konstaton se OE “Health & Light” SHPK argumenton dhe pranon faktin që specifikimi në fjale nuk është sipas katalogut të paraqitur në SPE.

Është detyrim ligjor i Operatoreve Ekonomik që të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mos diskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KVO ka vlerësuar ofertën në përputhje me Nenin 92, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”

KSHA gjykon se KVO ka vepruar drejt pasi, për të bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura, KVO-ja bazohet në dokumentet dhe katalogët e paraqitur në SPE dhe rezulton se dysheku është me lartësi 5 cm dhe jo sa është kërkuar nga AK

KSHA gjykon, se OE duke qenë në dijeni se në katalogun e kompanisë dysheku është me lartësi 5cm dhe jo 6 cm siç është kërkuar në dokumentet e tenderit, mund të kishte ushtruar të drejtën e tij të ankimimit për dokumentet e tenderit sipas afateve të përcaktuara në Nenin 110, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

OE argumenton se bazuar Ligjin nr. 162/2020 të “Prokurimit Publik”, Neni 92, pika 3 “Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

KSHA gjykon, se pavarësisht se pika në fjalë mund të konsiderohet devijim i vogël, KVO duhet të gjykojë vlefshmërinë e ofertave në tërësi. Nëse do të ishte mangësi vetëm kjo pikë do të mund të konsiderohej devijim i vogël por e bashkuar bashke me 4 pikat e tjera, në gjykimin e KSHA, KVO ka vepruar drejt duke e konsideruar jo në përputhje me specifikimet teknike.

Neni 2, pika d, i ligjit nr. 162/2020 Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është: d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Nëse ankesa do të pranohej, AK të njoftonte të gjithë OE se do pranoheshin variante me dimensione të ndryshme nga ato të përcaktuara duke garantuar një konkurrence të ndershme midis OE, por jo në këtë fazë të procedurës.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Health &Light” SHPK NUK qëndron.

3. Lidhur me pretendimin nr. 3 të ankimuesit për arsyen e skualifikimit si me poshtë:

Për Artikullin Nr.4 dhe Nr. 5 - Set me jastike silikonit rrethore per koken, 4 permasa — 1set.

Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar Nga shqyrtimi i ankesës dhe i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, KSHA konstaton se OE “Health & Light” SHPK argumenton qe specifikimi në fjalë është në përputhje me specifikimet teknike duke u mbështetur në dokumentin “Skeda e përputhshmërisë teknike dhe konfigurimi i ofruar”, citojmë:

Nëse do ti referoheni dokumentit të ngarkuar në sistem së bashku me ofertën dhe dokumentet e tjera) Skeda e përputhshmërisë teknike dhe konfigurimi i ofruar do të shihni që kemi deklaruar dhe ofruar fiks atë që kërkohet në specifikimet teknike:

CLOSED HEAD RING 9 X 4 X 2CM 60001 2

CLOSED HEAD RING 14 X 6 X 3.5CM 60002 2

CCLOSED HEAD RING 20 X 7.5 X 4, 5CM 60003 2

CLOSED HEAD RING 20 X 7.5 X 7.5CM 60004 2

Ky dokument bie ndesh me katalogun e paraqitur nga prodhuesi pasi asnjë nga referencat e paraqitura ne këtë dokument nuk korrespondojnë me katalogun e prodhuesit “Infimed”. Nëse këta aksesore ofrohen nga prodhuesi “Infimed” duhet të ishin paraqitur në katalog apo në një forme tjetër (manual përdorimi, skede me të dhëna teknike etj) të lëshuar nga prodhuesi.

KSHA gjykon se KVO ka vepruar drejt pasi, për të bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura, KVO-ja bazohet në dokumentet dhe katalogët e paraqitur në SPE dhe rezulton se nuk ka asnjë referencë në katalogun e prodhuesit “Infimed” që produktet e mësipërme janë produkt i prodhuesit “Infimed”.

KSHA gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave të vërtetonte se produktet që do të ofroje janë të prodhuesit “Infimed”.

Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK NUK qëndron.

4. Lidhur me pretendimin nr. 4 te ankimesit per arsyen e skualifikimit si me poshtë: Për Artikullin Nr.5:

- Fiksuesi kranial te kete referencen optike per neuronavigator.

Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun e paraqitur Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed mungon referenca optike per neuronavigator.

- Reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikulluar me montim ne fiksuesin kranial –I cope.

Specifikimi i kërkuar nuk plotësohet pasi nuk është ofruar aksesor i referencës optike si dhe krahu i artikuluar për montim në fiksuesin kranial. Në katalogun Kataloge të perkthyer Changzhou Huida të firmës prodhuese Huidamed është markuar artikulli "Navigation adaptor me kod HRO7021G" që nuk plotëson kërkesën as për referencën optike dhe as për krahun e artikuluar sic janë kërkuar.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i dokumentacionit të paraqitur në SPE, KSHA konstaton se OE "Health & Light" SHPK në plotësim të këtij specifikimi ka markuar në katalogun e prodhuesit HUIDAMED vetëm artikullin "Navigation adaptor me kod HRO7021G" fakt ky i pranuar edhe nga OE që ky aksesor është një adaptor dhe jo referencë optike kraniale e kërkuar. OE pretendon se ka ofruar gjithashtu artikullin me "Martin's Arm Retractor R400". Pas verifikimit të katalogut të prodhuesit HUIDAMED të paraqitur në SPE rezulton se nuk ka të markuar asnjë artikull me përshkrim "Martin's Arm Retractor R400 1" dhe për këtë arsye ky artikull nuk është marrë në shqyrtim.

Referuar edhe Certifikatës CE të paraqitur nga prodhuesi HUIDAMED ky artikull nuk rezulton të jetë pjesë e Certifikatës CE të paraqitur në SPE.

Pavarësisht faktit të mësipërm, artikulli "Martin's Arm Retractor R400 1" është një retraktor i përgjithshëm kranial i cili montohet në shtratin operator dhe jo në Fiksuesin kranial siç është kërkuar.

Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit HUIDAMED të paraqitur në SPE rezulton se artikulli i ofruar "Navigation adaptor me kod HRO7021G" nuk është një referencë optike kraniale por adaptor, për më tepër që nuk ka asnjë të dhënë teknike që ky adaptor montohet në krahun e artikuluar "Martin's Arm Retractor R400".

Gjithashtu nga verifikimi i katalogut të prodhuesit Huidamed rezulton që nuk ka asnjë produkt të ngjashëm me "Krah i artikuluar" dhe as "Referencë optike kraniale".

sa i përket pretendimit tuaj që ky specifikim shkon drejt OE O.E.S Distrimed, OE "Health & Light" SHPK nuk ka paraqitur asnjë argument apo prove ku të mbështesë pretendimin e tij se ky specifikim shkon drejt një operatori ekonomik.

Ky pretendim nuk qëndron edhe për faktin se në këtë procedurë prokurimi janë vlerësuar dy oferta të vlefshme të cilat kanë ofertuar krahun e artikuluar dhe referencën optike me të njëjtat specifikime dhe nga prodhues të ndryshëm.

Gjithashtu referuar Specifikimeve teknike, nuk rezulton të jete përdorur ndonjë markë apo emër tregtar specifik që mund të kufizonte konkurrencën.

Gjate fazës së përgatitjes së ofertave, nuk ka pas asnjë kërkesë për sqarim apo ankese në lidhje me këtë pretendim.

KVO ka vlerësuar ofertën në përputhje me Nenin 92, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" ku përcaktohet se:

Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”

KSHA gjykon se KVO ka vepruar drejt pasi, për të bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura, KVO-ja bazohet në dokumentet dhe katalogët e paraqitur në SPE dhe rezulton se nuk ka asnjë produkt të ngjashëm me “Krah i artikulluar” dhe as “Reference optike kraniale”.

Këta aksesore janë pjesë e rëndësishme e konfigurimit të artikullit nr. 5 - Shtrat operacioni për Neurokirurgjinë, përmes të cilit krijohet lidhja me pajisjen Neuronavigator siç është kërkuar në specifikimet teknike por gjithashtu mund të jenë aksesore me vlerë të konsiderueshme financiare prandaj mos ofrimi i këtij specifikimi dhe aksesoreve mund të shkaktoje pabarazi ndërmjet OE konkurrues.

Neni 2, pika d, i ligjit nr. 162/2020 Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është:

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

KSHA gjykon gjithashtu, se OE ankimues mund të kishte ushtruar të drejtën e tij të ankimimit për dokumentet e tenderit sipas afateve të përcaktuara në Nenin 110, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

*Nëse ankesa do të pranohej, AK të njoftonte të gjithë OE se do pranoheshin variante me konfigurime të ndryshme nga ato të përcaktuara duke garantuar një konkurrence të ndershme midis OE, **por jo në këtë fazë të procedurës.***

KSHA gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime.

Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK NUK qëndron.

Për sa është argumentuar më sipër, KSHA ka arritur në,

KONKLuzionin:

Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës për të katër pikat objekt ankese.

Për sa është argumentuar më sipër, si dhe në kuadër të frymës së transparencës të cilën legjislatori e synon nëpërmjet legjislacionit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore për

zbatim të tij, KSHA në respektim të detyrimeve që burojnë nga dispozitat e ligjit Nr.162/2020, Datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe VKM Nr.285 Datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ngarkuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit:

VENDOSI:

1. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Health & Light” SHPK.

Ky Vendim do të dërgohet dhe KPP-së e cila do të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të shqyrtimit të ankesës.”

II.9. Me shkresën e datës 08.09.2023 protokolluar me tonën me nr. 2130/6 prot., datë 12.09.2023 me lëndë: “Argumente për përgjigjen e AK në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje shtretër operacioni për ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT” me numër reference REF-73075-06-20-2023” është paraqitur informacion shtesë nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në mbështetje të ankesës së tij.

II.10. Me shkresën nr.2130/2 prot., datë 13.09.2023 me qëllim gjykimin e drejtë dhe objektiv të çështjes, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për zhvillimin e një seance dëgjimore me datë 15.09.2023 në mjediset e KKP.

II.11. Në datë 15.09.2023 u zhvillua në mjediset e KPP-së seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK, si dhe të autoritetit kontraktor Spitali Universitar i Traumës. Seanca dëgjimore u regjistrua audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.12. Nga shqyrtimi i materialeve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, pranë Komisionit të Prokurimit Publik në formë shkresore dhe as në sistem elektronik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit per artikullin 4 dhe 5- “Shtrat operacioni ortopedik baza të jetë çelik inoks 304 me arsyen se: “-specifikimi i kerkuar nuk plotësohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed

materiali per shtratin ortopedik eshte ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallen e kualitetit te celik inoksit 304.” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.6 Për të gjithë artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogun e prodhuesit “Infimed” të përkthyer dhe të noterizuar;*
- Katalogun e prodhuesit “Huidamed” të përkthyer dhe të noterizuar;*
- Skedën e përputhshmërisë teknike per lotin 4 të hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik ankimues.*

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast,

autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6, kapaciteti teknik, kriteret e veçanta të kualifikimit Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi.

III.1.6. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së me datë 15.09.2023 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për artikullin 4 dhe 5- “Shtrate operacioni ortopedike baza të jetë çelik inox 304 me arsyen se: *“-specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed materiali per shtratin ortopedik eshte ofruar me material celik inoksi por nuk tregon shkallen e kualitetit te celik inoksit 304.”*, pyetjes së Komisionit se në cilën faqe apo fragment të katalogut ose në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorë evidentohet, se produkti plotëson standardin e inoksit 304 të kërkuar nga autoriteti kontraktor, administratori i autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur i është përgjigjur se: *“Në momentin kur ne paraqitem ofertën morëm edhe konfirmimet nga kompania prodhuese e cila është një kompani europiane. Bëhet fjalë për vetë aparatin nga pikëpamja strukturore që duhet të jetë çelik inoksidabël 304. Markat kryesore të çelikeve janë 304 dhe 3016 L. (administratori i operatorit ekonomik ankimues vë në dispozicion të KPP-së një dokument me 2 fletë ku është një link i En Wikipedia.org ne lidhje me celikun 304 ne gjuhen angleze). Ne kete dokument ashtu si në të tjera që hynë ne gamën e*

metalurgjise aty shpjegohet se celiku inoksidabël i markës 304 është celiku me i zakonshmi i cili sherben per kontraktimin e pajisjeve mjeksore. Nga ana jone kemi komunikuar dhe me kompaninë dhe nga ana e tyre kemi marrë konfirmimin per cilesine e celikut te kerkuar sipas specifikimeve teknike. (OE ve ne dispozicion te KPP nje dokument me 1 flete me emertimin e-mail derguar nga Infimed.pl per shoqerine "Health and Light" SHPK date 21.08.2023 ne gjuhen angleze administrohet si pjesë e dosjes.) Praktikisht ky celik eshte celiku me i zakonshëm i cili gjendet ne te gjitha strukturat metalike ne ambientet spitalore. Nje kompani europiane e cila eshte e certifikuar me CE dhe me ISO nuk e gjen me vend te cilesoje ne kete katalog te sajine mbarë botëror dhe qe është edhe pajisje ne Bashkim European "The most common stainless steel") Ne dokumentin e parë qe ju parashtroam që në paragrafin e parë e cilëson pikërisht të tillë. Nga ana jone ne prezantimin e dokumentacionit qe beme gjate procedures se tenderit kur i hodhem online ne kemi paraqitur edhe perputhshmerine teknike eshte nje skede (nga ana e KPP administrohet nje skede e perputhshmerise loti 4 e cila eshte depozituar edhe ne SPE.). Ndërkohë pyetjes së Komisionit, nëse dokumentacioni për markën e celikut është i dorëzuar ne SPE, pra e-mailet e dorëzuara nga operatori ekonomik janë dorëzuar në SPE dhe a ka ndonjë dokument tjetër të dorëzuar në SPE para datës së dorëzimit të ofertave ku konfirmohet nga prodhuesi në një mënyrë apo tjetër që ky çelik është i kësaj marke të kërkuar, operatori ekonomik i përgjigjet: *Nuk ka sepse prodhuesi vete e konsideron aq te zakonshme përdorimin e minimumit të cilësisë se çelikut 304 sa nuk e ka vendosur as ne manual e as ne katalog. Pa përdorur këtë markë ai nuk do te ishte i aftë të merrte as certifikatën për produktin. Çeliku 304 eshte ai cili përdoret per sallat e operacionit qe siguron sterilitet dhe qendrueshmeri per ambjentik koraziv qe është. Pra pa përdorur këtë material ai as nuk do e certifikonte produktin pra ata e konsiderojne aq te zakonshme aq te ditur si fakt sa nuk shohin arsye ta vendosin ne katalog.*"

Ndërsa pyetjes së KPP-së, nëse gjatë vlerësimit të ofertave nga KVO, është parë i nevojshëm dërgimi i kërkesës për informacion në lidhje me markën e celikut për sa kohë nga e OE konsiderohet si një markë e zakonshme, pra është parë e nevojshme kërkesa për sqarim drejtuar OE, autoriteti kontraktor i përgjigjet se: *"KVO bazuar në dokumentet e paraqitura nga operatori ekonomik në asnjë pike apo dokument nuk ka konstatuar se çeliku i inoksit apo produkti i ofertuar i përket klasit 304. Te ndodhur ne këto kushte KVO nuk e ka parë të arsyeshme ti kërkojë sqarime sepse ne specifikime teknike dhe ne deklaratën e përputhshmërisë teknike nuk e ka konstatuar ne asnjë pikë e klasin e inoksit çelik."*

Operatori ekonomik shton me tej se: *"Ne baze te ligjit për prokurimin publik neni 92 pika 1 apo 3 Autoriteti Kontraktor kur ka paqartësi apo dyshime ne lidhje me cilesine e produktit te paraqitur po ndonje devijim ose dicka te paqartë ka mundesine ti drejtohet operatorit ekonomik me shkrim, online nëpërmjet mesazheve te Agjencisë së Prokurimit Publik për te parashtuar çdo paqartësi dhe OE te parashtrojë sqarimet e veta po për këtë çështje."*

III.1.7. Nisur nga arsyeja e skualifikimit te operatorit ekonomik ankimes, pergjigja e autoritetit kontraktor ne lidhje me argumentimin e skualifikimit te tij, nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem nga ankimuesi, dokumentacioni sqarues i paraqitur në KPP përmes shkresës së datës 08.09.203 të dërguar në KPP nga ankimuesi protokolluar me tonën me nr. 2130/6 prot., datë 12.09.2023, si dhe deklaratimet e palëve në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së më datë 15.09.2023, vihet re se ky i fundit i përmbush specifikimet teknike për artikullin 4 dhe 5 lidhur me kërkesën "baza të jetë çelik inox 304", pasi në

dokumentin “Skeda e përputhshmërisë teknike loti 4” për kërkesën si më sipër, ka shënuar plotësohet “Po” dhe te shënime ka referuar faqen 3 në katalogun e prodhuesit “Infimed” sipas të cilit plotësohet ky specifikim teknik. Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit “Infimed” për plotësimin e këtij specifikimi teknik, vihet re, se nuk është specifikuar grada 304 siç autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit. Ndërkohë nga dokumentacioni sqarues i dërguar nga operatori ekonomik ankimues në KPP me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 2130/6 prot., datë 12.09.2023 ka bashkëngjitur e-mail e prodhuesit Infimed i cili shprehet: “ Yes of course it’s made of AISI 304. It’s a obvious information, we don’t put in te catalogue.”, dokument ky i cili u depozitua në KPP nga operatori ekonomik ankimues edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së me datë 15.09.2023. KPP duke gjykuar mbi përmbajtjen e e-mailit të dërguar nga prodhuesi Infimed në lidhje me gradën e celikut inoks, ka marrë sqarimin e duhur që kualiteti i inoksit për pajisjet 4 dhe 5 është 304 siç autoriteti kontraktor ka kërkuar në dokumentet e tenderit. Nga ana tjetër vetë autoriteti kontraktor në seancë dëgjimore shprehet, se nuk e ka parë të nevojshme të kërkojë sqarime në lidhje me kualitetin e inoksit për sa kohë nuk ka qenë e përcaktuar në katalog. Nisur nga veprimet e autoritetit kontraktor dhe pohimet e tyre në seancë dëgjimore KPP gjykon, se ky i fundit nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet e nenit 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Autoritetit kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes pa cenuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë në përmbushje të qëllimit të *lex specialis* të parashikuar në nenin 2 të tij. Duke qenë se autoriteti kontraktor referuar SPE, informacionit të dërguar nga ai si pjesë e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe nga vetë pohimet e tij në seancë dëgjimore, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 92 pika 1 të *lex specialis*, si dhe operatori ekonomik me sqarimet e dhëna e përmbush kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, Komisioni gjykon, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për artikullin nr.4 dhe nr.5 - *Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit.*” me arsyen se: “-*Specifikimi i kerkuar nuk plotësohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5 cm.*” KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.6 Për të gjithë artikujt e kerkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.2.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogun e prodhuesit “Infimed” të përkthyer dhe të noterizuar;
- Katalogun e prodhuesit “Huidamed” të përkthyer dhe të noterizuar;
- Skedën e përputhshmërisë teknike per lotin 4 të hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik ankimues.

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të

paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6, kapaciteti teknik, kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi.

III.2.5. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së me datë 15.09.2023 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Health & Light" SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit per artikullin nr.4 dhe nr.5 - *Dyshek memory jo me pak se 6cm me veshje antistatike dhe kundra ujit.* me arsyen se: *"-Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar 5 cm."* pyetjes së Komisionit se cili është roli i specifikimit teknik ne lidhje me trashësinë e dyshekut dhe si ndikon kjo në funksionalitetin e pajisjes sepse edhe sipas autoritetit kontraktor ky konsiderohet si një devijim i vogël, përfaqësuesi i autoritetit kontraktor (juristi) në mënyrë të përmbledhur i është përgjigjur se: *"Kur autoriteti kontraktor ka hartuar specifikimet teknike në përbërje të të cilit ka qene edhe specialisti i fushes trashesine e dyshekut ka menduar se kjo trashesi i perket mbarëvajtjes së punës dhe ndërhyrjeve kirurgjikale me sukses. Një dyshek jo konform kushteve të specifikimeve teknike do të sjellë si pasojë mospranimin e ketij produkti nga ana e komisionit te pritjes se mallit. Nese komisionit te vleresimit te ofertave do ti dukej si nje devijim i vogel mund te ndodhe qe grupi i pritjes se mallit qe ka ne perberje edhe specialist te fushes mund te mos e pranoje kete produkt dhe pasoja do te ishte me e madhe se vete vleresimi. Nje komisioni pritje malli nuk mund te pres nje produkt qe nuk eshte konform specifikimeve.*

Pyetjes së Komisionit drejtuar autoritetit kontraktor se cili është roli i dyshekut ne funksionalitetin e kerkuar përfaqësuesi i autoritetit kontraktor i përgjigjet: *"Po flasim për dyshek që përbëhen nga xheli që vendosen siper shtratit operator mbi të cilin qëndron*

pacienti. Nuk kam qene pjese e grupit te hartimit te kriterëve por koleget e mi kete kriter besoj e kane vendosur ne baze te nevojave te meparshme qe ne kemi pasur. Jane shtretër prej xheli te cilët pas nje periudhe amortizohen dhe duhen nderruar, kjo eshte arsyeja e ketij tenderi. Personalisht nuk di te them nese permasa e duhur duhet te tjete 4 5 6 8 kjo varet nga ata qe kane hartuar oferten. Llogjikisht do te synoja gjithnje per numrin me te larte te mundshem.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor pas kërkesës së Komisionit për të qartësuar nëse pretendimet për këtë pikë pranohen apo jo, sepse nga mënyra se si autoriteti kontraktor ishte shprehur kjo krijonte konfuzion nëse e ka pranuar këtë pretendim apo jo, ka sqaruar se: *“Nuk konsiderohet e pranuar sepse autoriteti kontraktor e ka shprehur vullnetin e vet me akte dhe nuk ëshë pranuar.”*

Pyetjes së Komisionit, se në katalogun e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ku evidentohet trashësia, është kjo trashësi e evidentuar saktë nga autoriteti kontraktor, pra prej 5 cm apo plotësohet në një menyre të ndryshme nga ana e operatorit ekonomik ankimes ky i fundit i përgjigjet se: *“Është 5 cm ose 50 mm dhe per pretendimin e Autoritetit Kontraktor se do kene probleme me marrjen ne dorezim te mallit kjo nuk eshte e vertete sepse ne aneksin e kontratës ne do vendosin skeden qe ne kemi dorezuar kështu qe Komisioni do prese nese malli i dorezuar eshte konform specifikimeve te ofruara nga ne dhe jo specifikimeve te kerkuara nga komisioni pra do te marrë në konsiderate dhe ato devijime te vogla dhe kjo nuk qendron. E dyta ka diskutime per te hyre pastaj ne trashësinë 5 cm apo 6 cm qe ne fillim kur eshte kerkuar megjithese tani nuk kemi te drejte ta diskutojme kete se nuk jemi ankuar nuk kerkohet me pak se 6 cm mund te thuhet afersisht 6 cm sepse te gjithë e dime se 6 cm me 5 cm nuk ka asnje lloj relevance ne performance madje 5 cm eshte me i mire se 6 sepse mund te shkaktoje levizje minimale qe mund te kene aspekte negative ne punen e kirurgut.*

Pyetjes së KPP-së nëse autoriteti kontraktor ka kërkuar variante në kuptim të ligjit për prokurimin publik neni 4, autoriteti kontraktor i është përgjigjur se: *“Kjo nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor.”*

Ndërsa pyetjes së KPP për të ditur vlerësimin e operatorit ekonomik nëse specifikimi teknik i kërkuar prej 6 cm është i drejte dhe ky mund të konsiderohet devijim i vogël apo ky specifikim mund te cenojë konkurrencën dhe ka vetëm një prodhues të vetëm që ofron një dyshek me trashësi 5 cm, operatori ekonomik i është përgjigjur: *“Absolutisht kjo nuk kufizon konkurrencën ne mund te ofronim edhe 8 cm por duke konsideruar qe 6 cm me 5 cm është me afër 5 cm kemi ofruar 5 cm edhe për te miren e autoritetit kontraktor per te pasur nje performance dhe nje shfrytezim sa me te denje te pajisjes. Diskutimi sa i përket trashësisë së dyshekut operator bëhet fjalë për një vlerë 150-200 euro e cila ne kuadrin e gjithë diskutimit të shtratit operator te marrë ne menyre integrale eshte nje vlerë e papërfillshme. Zoteria i autoritetit kontraktor thotë që ka marre mendimin e specialisteve te fushes por mund jete marre indikacion nga nje katalog i caktuar. Ndoshta është marrë kjo gjë ne mënyrë arbitrare që në momentin që bëhet vlerësimi i një operatori të cakuar për ofertën që ka dhënë të ketë sa më shumë agumente.*

Komisioni ndërhyr duke shtuar se: *Ju mund te identifikoni ne kuptim te nenit 36 te ligjit qe ky specifikim te orienton drejt nje produkti të vetem? Nese mund ta indetifikoni se ky specifikim*

te orienton drejt ne produkti te vetem mund tia vini ne dispozicion KPP-së.” Ndërkohë operatori ekonomik ankimues i përgjigjet se: “Është e vështirë të bëjmë këtë lloj cilësimi sepse sot ne bote ka mjaft prodhues te cilet jane te certifikuar me CE te cilet vijne nga lindje e larget dhe nga Kina, produkte qe e permbushin kete lloj specifikimi.

Autoriteti kontraktor shton me tej: *“Nese do te kisha qenë në rolin e kompanise ne fjale po flas si specialist gjithmone dhe nese do kisha ne dispozicionin tim dy lloj dyshekesh 5 cm dhe 8 cm ne nje tender me specifikime teknike jo me pak se 6 logjikisht do të kisha hyrë me 8 cm jo me 5 pese do të isha i përjashtuar automatikisht. E dyta prape duke pare rastin e çelikut qofte 304 apo 316 nuk kam informacion sepse nuk eshte fusha ime do kisha marre te dhena serioze nga nje institucion i pranuar nderkombëtarisht ku te provohej ekuivalenti ku ky institucion te provonte qe ky produkt ka te njëjtat specifikime teknike me 304, nuk mund te vijme ketu me referenca te wikipedia apo e-mail nga kompania meme e cila është ne konflikt interesi, ate do shkruaje. Do preferoja nje institucion monitorues jashte ketyre të autorizuar per te dhene specifikimet teknike te celikut kirurgjikal apo jo dhe te thoshte qe 316 eshte ekuivalenti i 304 dhe ketu autoriteti kontraktor duhet ta tërhiqte kërkesën sepse do ishte e njëjta gje, do ishte e provuar.*

Operatori ekonomik shton: *“Ne kemi dhene 304 qe përdoret per ambientet e operacionit por nese do na kerkonit sqarim do ju kishim vene ne dispozicion dokumentet zyrtare jo wikipedia per ta konfirmuar, por ju nuk na kerkuat sqarim, na skualifikuat. E përmendëm dhe me parë kjo kompani me te cilen ne kemi paraqitur ofertë është një kompani polake brenda BE dhe kur ka marre certifikimin për këtë aparat është nonsens te dikutojme sepse vete 304 në të gjitha literaturat botërore është më i zakonshmi që gjendet ne ambientet spitalore.”*

III.2.6. Nisur nga arsyeja e skualifikimit te operatorit ekonomik ankimues, nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem nga ankimuesi, si dhe nga pohimet e palëve në seancë dëgjimore vihet re, se ky i fundit me katalogët e paraqitur në SPE nuk i permbush specifikimet teknike per artikullin 4 dhe 5 lidhur me kërkesën *“Dyshek memory jo me pak se 6 cm me veshje antistatike dhe kundra ujit.”* pasi në dokumentin *“Skeda e përputhshmërisë teknike loti 4”* për kërkesën si më sipër ka shënuar plotësohet *“Po”* dhe të shënime ka referuar faqen 3 në katalogun e prodhuesit *“Infimed”*, sipas të cilit plotësohet ky specifikim teknik. Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit *“Infimed”* i përkthyer dhe i noterizuar për plotësimin e këtij specifikimi teknik vihet re se është përcaktuar: *“Dyshekë antistatikë të cilësisë së lartë, me profil ergonomik të punuar me shumë poliuretani me trashësi 50 mm”*. Lidhur me këtë fakt Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk ka hartuar një ofertë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi kërkesat e autoritetit kontraktor janë për dyshek me trashësi *jo me pak se 6 cm dhe jo 50 mm (ose 5 cm)* siç ka ofertuar operatori ekonomik ankimues dhe ofertat që nuk përmbushin të gjitha kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike duhen refuzuar si oferta të pasuksesshme. Akoma më tej, ashtu sikurse dhe u pohua në seancë dëgjimore, autoriteti kontraktor nuk ka pranuar variantet në dokumentet standarde të tenderit me qëllim që Komisioni i Prokurimit Publik të gjykonte edhe mbi mënyra të tjera alternative të përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor nga ana e operatorit ekonomik me kushtin që të mos dëmtohej funksionaliteti dhe performanca e pajisjes. Gjithashtu, edhe vetë operatori ekonomik ankimues ka dështuar të provojë në seancë dëgjimore nëse një specifikim i tillë të

çon drejt një prodhuesi dhe produkti të vetëm dhe çënon konkurrencën në procedurat e prokurimit publik. Komisioni risjell në vëmendje faktin, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime mbi kriteret për kualifikim apo specififikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural për paraqitjen e ankesës për dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 110 të lex specialis apo kërkesën për sqarime pranë autoritetit kontraktor, garanci procedurale këto që i ofrohen operatorëve ekonomikë me qëllim vënien në vend të shkeljes së pretenduar dhe përmbushjen e interesit të tyre të ligjshëm. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse dhe deklarimeve në seancën dëgjimore, të datës 15.09.2023, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për artikullin nr.4 dhe nr.5 - *Set me jastike silikon rrethore per koken, 4 permasa — 1set.*” me arsyen se: *“Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar.”* KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “kapaciteti teknik” pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.6 Për të gjithë artikujt e kerkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specififikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emerimin dhe specififikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.3.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- *Katalogun e prodhuesit “Infimed” të përkthyer dhe të noterizuar;*
- *Katalogun e prodhuesit “Huidamed” të përkthyer dhe të noterizuar;*
- *Skedën e përputhshmërisë teknike per lotin 4 të hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik ankimues.*

III.3.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6, kapaciteti teknik, kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.3.2 të këtij vendimi.

III.3.5. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së me datë 15.09.2023. lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për artikullin nr.4 dhe nr.5 - *Set me jastike silikoni rrethore per koken, 4 permasa — 1set.*” me arsyen se: *“Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun Kataloge te perkthyer Infimed te firmes prodhuese Infimed eshte ofruar ne forme patkoi dhe jo ne forme rrethore si dhe nuk ka te percaktuar qe ofrohen 4 permasa te ndryshme sic eshte kerkuar.”* pyetjes së Komisionit se në katalogun e dorëzuar nga ai në SPE si përmbushen specifikimet teknike për këto produkt, operatori ekonomik ankimues është përgjigjur se: *“Në katalog prodhuesi ka dhënë një ilustrim të aksesoreve të cilët nuk janë pjese integrale e pajisjes dhe ai ka zgjedhur te jape nje ilustrim ku per kete prodhues ose si e ka menduar ai nuk ka nje pamje te jastekut rrethor por ka nje pamje te jastekut ne forme patoi dhe nje pamje te jastekut në formë katrore keshtu e ka konsideruar ai. Nderkohe ne, në skeden tone te perputhshmerise kemi evidentuar permasat qe kemi ofruar bashke me kodin referuar te prodhuesit por nuk kemi pas nje katalog me te detajuar per ti treguar autoritetit kontraktor. Si e tille nuk e kuptoj se ku eshte devijimi ketu edhe po ti kishim ofruar ne forme patkoi ata e dine shume mire qe do ishte me mire per ta por ne kemi ofruar ate qe eshte kerkuar dhe pershkrimi yne eshte te skeda e perputhshmerise nje dokument me firme e vule që ne mbajme pergjegjesi.*

Pyetjes së Komisioni, nëse skeda e përputhshmërisë është lëshuar nga operatori ekonomik apo nga prodhuesi i produkteve, operatori ekonomik i është përgjigjur: *“Nga ne si operator mbështetur mbi inputet e prodhuesit.”*

Ndërkohë pyetjes së Komisionit drejtuar përfaqësuesve të autoritetit kontraktor mbi mënyrën si është kryer vlerësim në lidhje me këtë pikë, a kanë patur nevojë për sqarim apo paqartësi, cili është roli i formës së jastekut, dhe cili është ndryshimi në nivel teknik midis formës rrethore dhe formës së patkoit, operatori ekonomik i është përgjigjur: *“Kemi ofruar closed head ring pillow. Zotërinjtë e komisionit te vleresimit kane parë vetem ilustrimin qe prodhuesi ka vendosur ne katalog qe aty eshte nje fotografi e ketyre jastekeve dhe me qe aty nuk kanë qenë forma rrethore e kane konsideruar qe keta ne forme rrethore nuk kanë, kane katrore dhe ne forme patkoi keshtu qe nuk e kane ofruar kete nëse do kishin ndonjë paqartesi permasa dhe forma katrore ne katalog nuk ka pas por mund te kishin kerkuar sqarim por ne e themi me pergjegjesi të plotë që ne kemi ofruar atë që është kërkuar dhe kemi paraqitur edhe permasa. Nuk i themi dot prodhuesit na prodho nje katalog per Spitalin Ushtarak, nuk e kemi atë fuqi.*

Auoriteti kontraktor vazhdon akoma më tej: *“Nëse prodhuesi juaj disponon jastëkë të formës rrethore dhe jo patkua sipas perjashtimit qe eshte bere une mendoj qe ky eshte nje problem lehtësisht i zgjidhshëm mjafton të shtohet dokumentacion shtesë dhe ky specifikim plotësohet.*

Operatori ekonomik shton: *“Kush na e kërkoj sqarimin.?”*

III.3.6. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes, nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem nga ankimesi, si dhe nga deklaratimet e palëve në seancë dëgjimore, vihet re se ky i fundit me katalogët e paraqitur në SPE nuk i përmbush specifikimet teknike për artikullin 4 dhe 5 lidhur me kërkesën “*Set me jastike silikoni rrethore për koken, 4 permasa — Iset .*” pasi në dokumentin “Skeda e përputhshmërisë teknike loti 4” për kërkesën si më sipër, ka shënuar plotësohet “Po” dhe të shënime ka referuar faqen 25 në katalogun e prodhuesit “Infimed”, sipas të cilit plotësohet ky specifikim teknik. Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit “Infimed” i përkthyer dhe i noterizuar për plotësimin e këtij specifikimi teknik vihet re, se është përcaktuar një set me tre permasa në formën e patkoit, pra jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, në skedën e përputhshmërisë teknike në lidhje me përmbushjen e specifikimit teknik më sipër, operatori ekonomik ka dhënë referencat CLOSED HEAD RING 9 X 4 X 2CM 60001 2 ;CLOSED HEAD RING 14 X 6 X 3.5CM 60002 2 ;CLOSED HEAD RING 20 X 7.5 X 4, 5CM 60003 2; CLOSED HEAD RING 20 X 7.5 X 7.5CM 60004 2, por këto referenca nuk gjejnë asnjë përcaktim në katalogun e prodhuesit “Infimed”, i paraqitur nga operatori ekonomik në SPE për përmbushjen e kriterit më sipër, mbi bazën e të cilëve do të kryhej edhe verifikimi në lidhje me plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik i cili është parë nga ligji si një organ *quasi gjyqësor*, si dhe me veprimtarinë e tij si një organ *super partes*, gjykon vetëm mbi bazën e kritereve të hartuara nga autoritetet kontraktore dhe dokumentacionit të paraqitur në sistemit elektronik nga operatorët ekonomik ankimes. Skeda e përputhshmërisë të cilën operatori ekonomik ankimes e ka paraqitur në sistem është një dokument orientues mbi përmbushjen e kriterit të kërkuar më sipër, e cila i shërben organit vlerësues të ofertave, atij shqyrtues të ankesave si dhe Komisionit të Prokurimit Publik për t’u orientuar drejt dhe qartë, se si dhe ku përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në katalogun e prodhuesit, por nuk mundet që kurrësi të zëvendësojë përmbajtjen e këtij të fundit, për sa kohë është dokumenti bazë mbi të cilin përmbushet ose jo kriteri i kërkuar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimes duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për Artikullin Nr.5:

- *Fiksuesi kranial të kete referencen optike per neuronavigator” me arsyen se: “Specifikimi i kerkuar nuk plotësohet pasi në katalogun e paraqitur Kataloge të perkthyer Changzhou Huida të firmes prodhuese Huidamed mungon referenca optike per neuronavigator.”*

- *Reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikular me montim ne fiksuesin kranial –l cope.” me arsyen se: “Specifikimi i kerkuar nuk plotësohet pasi nuk*

eshte ofruar aksesori reference optike si dhe krahu i artikuluar per montim ne fiksuesin kranial. Ne katalogun Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed eshte markuar artikulli " Navigation adaptor me kod HRO7021G" qe nuk ploteson kerkesen as per referencen optike dhe as per krahun e artikuluar sic jane kerkuar" KPP vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, "kapaciteti teknik" pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.6 Për të gjithë artikujt e kerkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike) te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

III.4.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogun e prodhuesit "Infimed" të përkthyer dhe të noterizuar;
- Katalogun e prodhuesit "Huidamed" të përkthyer dhe të noterizuar;
- Skedën e përputhshmërisë teknike për lotin 4 të hartuar, nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik ankimues.

III.4.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."

Në nenin 40 "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave" pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se: "3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast,

autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimues, me qëllim përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6, kapaciteti teknik, kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.4.2 të këtij vendimi.

III.4.5. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së më datë 15.09.2023, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Health & Light” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për Artikullin Nr.5:

- *Fiksuesi kranial te kete referencen optike per neuronavigator” me arsyen se: “Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi ne katalogun e paraqitur Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed mungon referenca optike per neuronavigator.”*

- *Reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikuluar me montim ne fiksuesin kranial –l cope.” me arsyen se: “Specifikimi i kerkuar nuk plotesohet pasi nuk eshte ofruar aksesori reference optike si dhe krahun i artikuluar per montim ne fiksuesin kranial. Ne katalogun Kataloge te perkthyer Changzhou Huida te firmes prodhuese Huidamed eshte markuar artikulli ” Navigation adaptor me kod HRO7021G” qe nuk ploteson kerkesen as per referencen optike dhe as per krahun e artikuluar sic jane kerkuar”* pyetjes së Komisionit drejtuar operatorit ekonomik ankimues, se ku mund të evidentohet në katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik përmbushja e specifikimeve teknike më sipër, ai është përgjigjur se: *“Mund te paraqesim edhe nje evidence tjeter është një deklaratë nga*

vetë prodhuesi (operatori ekonomik dorëzon në seancë nje deklaratë të noterizuar nga noteri publik me nr. 6618, datë 14.09.2023 nga prodhuesi Infimed përkthyer në gjuhën shqipe ku prodhuesi konfirmon se adaptor i navigimit (HR07021G) dhe tërheqësi i përshtatësit të krahut Martin (R400) të ofruar shërbejnë si referencë optike për neuronavigimin.)

Pyetjes së Komisionit nëse në katalogun e dorëzuar në SPE ky specifikim teknik evidentohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, operatori ekonomik i është përgjigjur: *“Ne katalog përveç sistemit të fiksimit kranial ndër aksesorët e tjerë që prodhohen nga i njejtë prodhues Hyidamed është dhe nje neuronavigator adopter kete bashkë me krahun Martin Arms i cili nuk është në katalog prodhuesi na e paraqet dhe sipas pershkrimit dhe specifikimit të kërkuar si referencë optike për neuronavigator pra ato na garantojne qe perdorimi i te dyjave bashke me sistemin e fiksimit kranial sherbejnë dhe bejne plotesisht detyrën e kerkuar nga autoriteti kontraktor per reference optike.*

Komisioni sqaron me tej: *“Pra ju deklaroni se fiksuesi kranial është në katalog ndërsa referenca optike kraniale nuk është në katalog por jepet me deklaratë nga prodhuesi ne një moment të dytë?”* Operatori ekonomik përgjigjet: *“Vetëm Martin Arm Retractor nuk është në katalog. Autoriteti kontraktor nuk ka ndonjë pretendim mbi cilësinë dhe tërësinë e fiksuesit kranial që ne kemi ofruar ata thonë që ky duhet të jetë i pajisur me referencë optike për navigatorin. Për këtë qëllim ne i kemi ofruar dy aksesor që i bashkëngjiten këtij fiksuesi kranial i cili është neuronavigation adopter dhe Martin Arms retractor, të dyja realizojnë qëllimin.”*

Pyetjes së Komisionit nëse këto dy produkte janë të saktësuar në katalogun e paraqitur nga operatori ekonomik në SPE, operatori ekonomik i është përgjigjur: *“Njëri nga ato është i saktësuar në katalog, tjetri nuk është i saktësuar në katalog .”*

Komisioni pyet më tej: *“Vetëm me njërin e dorëzuar në katalog realizohet qëllimi i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor?”* Operatori ekonomik përgjigjet: *“Jo duhet dhe Martin Arms Retractor dhe këtë e kemi shprehur dhe te deklarata jonë e përputhshmërisë.”*

Pyetjes së Komisionit nëse nga katalogu i dorëzuar ne SPE nga operatori ekonomik ankimes arrihet të kuptohet qëllimi i kërkuar, mënyra e përmbushjes së specifikimit teknik, që fiksuesi kranial të ketë referencë optike për neuronavigator, autoriteti kontraktor i përgjigjet: *“Bazuar ne dokumentin e paraqitur nga operatori ekonomik ne Agjencinë e Prokurimit Publik nuk rezulton se produktet e kërkuar të jenë në përputhje me specifikimet teknike si dhe të jenë të cilësisë në përputhje me specifikimet teknike. Gjithashtu, referuar edhe certifikatës CE ky artikull nuk rezulton te jete i paraqitur.”*

Pyetjes së Komisionit nëse me aksesoret e dorëzuar arrihet të vërtetohet se produkti fiksues kranial ka referencë optike për neuronavigator, autoriteti kontraktor i përgjigjet: *“Jo nuk rezulton të ketë krah të artikuluar dhe as referencë optike kraniale.*

Komisioni me qëllim sqarimin edhe me tej nga pikëpamja teknike dhe profesionale pyet ekspertin e fushës (pas vënies në dispozicion të tij nga ana e Komisionit të katalogut të paraqitur nga operatori ekonomik në sistem) nëse me specifikimet e paraqitura më sipër arrihen të përmbushen kërkesat e autoriteti kontraktor, dhe ku ai i përgjigjet se: *“Nuk kam informacionin e duhur për të shprehur nëse adaptor është ne ato përmasa apo specifikime teknike të pajisjes së neuronavigimit në spital por mund të them me siguri që po flasim për pajisje relativisht të komplikuar që nëse njëri nga komponentët bëhet opsuletë e gjithë pajisja nuk funksionon pra pergjithesisht kemi pasur tendencën që të jemi shume rigoroz ne*

pergjedhjen e këtyre pajisjeve që të jenë të adaptueshme apo të certifikueshme që funksionojnë sipas software dhe hardware bashke.”

Më tej operatori ekonomik ankimes pyet autoritetin kontraktor: *“Kush është marka e neuronavigatorit që perdorni në spital dhe a lejon marka që ju keni në spital të punojë me referenca optike të sistemeve kraniale të prodhuara nga shumë prodhues apo nga një?”* Autoriteti kontraktor përgjigjet: *“Fatkeqësisht neuronavigatori perdoret nga departamenti i neurokirurgjisë, unë jam ortoped në pamundësi për të qenë sot i pranishëm këtu neurokirurgu. Marken nuk e njoh me sinqeritet ajo që është aktualisht në spital por kam besimin e plotë që gjithë specifikimet teknike që janë të shkruara në kërkesë janë përpiluar nga vete neurokirurget.*

Operatori ekonomik shton: *“Kam hallin sepse për ko incidence furnizuesi i neuronavigatorit është ai që ju do të shpallni fitues dhe nese kjo është e vertetë është për të ardhur keq që ju të kerkoni një referencë optike që e oferton vetëm ai që ka ofruar neuronavigatorin dhe nuk do ishte kjo mënyra e duhur e prokurimit për këtë aksesori.*

Pyetjes së Komisionit, nëse nga ana e operatorit ekonomik janë kërkuar sqarime në lidhje me këtë pikë pranë autoritetit kontraktor, operatori ekonomik i përgjigjet: *“Për ne nuk ka qenë e nevojshme të kërkojmë sqarime, për ne prodhuesi na e konfirmon se kjo e ben detyren e vet si referencë optike. Për të tjera pretendime që ka autoriteti kontraktor nuk e di ata mbase presin dicka tjetër tu ofertohet por në këtë kemi për atë që ata kanë kërkuar. Nqs kërkojnë pershtatshmeri me pajisjen që kanë aty atehere nuk është kjo mënyra e prokurimit, nxjerr prokurim të drejtpërdrejtë për atë që ata duan.*

Autoriteti kontraktor shton më tej, se *“Operatori ekonomik kishte mundësi që 7 dite pas publikimit të tenderit që këtë informacion që pohoi këtu para jush ta paraqiste me shkrim dhe në si autoritet kontraktor të merrnim brenda afateve ligjore për të bërë saktësime nese kjo është e vertetë që neuronavigatori jone punon vetëm me një adaptor.*

Nga një kërkim i bërë nga ana ime rezulton se punon me të paktën 3 kompani. Operatori ekonomik shton: A kjo kompani nuk është kjo e jona?

Autoriteti kontraktor përgjigjet: *Këtë nuk di ta them unë por unë të paktën 3 kam gjetur.*

KPP sqaron me tej, se kjo nuk është arsye skualifikimi apo nuk është ngritur pretendim për papërpunshmëri të navigatorit të kërkuar me atë që disponon autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik në mbyllje shton: *“Kur behet fjale për një kompani europiane e cila paraqet edhe një deklaratë të saj për tërësinë e kompatibilitetit të specifikimeve teknike, nuk dua ti paragjykoj kompanitë në Lindjen e Largët dhe në mënyrë konfirmimin nga ana e tyre që referenca ishte mesë adapte për atë që ishte kërkuar dhe na u duk e panevojshme që të paraqesim këto lloj gjeje. Zakonisht në cdo procedurë prokurimi sa herë që shohim ndonjë specifikim i cili mund të jetë lehtësisht jo për faj të autoritetit i cili mund të ketë një indikacion për një produkt jo se ka preferencë, paraqesim gjithmone pranë autoritetit kontraktor sugjerimet, kërkesat për sqarim apo modifikim të specifikimeve teknike.”*

III.4.6.Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes, nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem nga ankimesi, si dhe nga pretendimet e palëve në seancë dëgjimore, vihet re se ky i fundit me katalogun e paraqitur në SPE nuk i përmbush specifikimet teknike për artikullin 5 lidhur me kërkesat për *“Artikullin Nr.5:*

- Fiksuesi kranial të këtyre referencen optike për neuronavigator”

- *Reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikular me montim ne fiksuesin kranial –l cope.*”, pasi në dokumentin “Skeda e përputhshmërisë teknike loti 4” për kërkesat si më sipër ka shënuar plotësohet “Po” dhe te shënime ka referuar faqen 7 në katalogun e prodhuesit “Huidamed” “Cranial Stabilisation System”, si dhe ka shënuar “Navigation Adaptor + Martin’s Arm Retractor” sipas të cilit plotësohen këto specifikime teknike. Nga verifikimi i katalogut të prodhuesit “Huidamed” i përkthyer dhe i noterizuar për plotësimin e këtij specifikimi teknik vihet re se është përcaktuar: “*Navigation Adaptor Code; HR07021G*”. Lidhur me këtë fakt Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk ka hartuar një ofertë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi në katalogun e paraqitur nuk evidentohet pajisja Martin Arm’s retractor ashtu siç operatori ekonomik ka shënuar te skeda e përputhshmërisë teknike, si dhe nga deklaratimet e bëra në seancë dëgjimore, vetë operatori ekonomik ankimes ka deklaruar, se aksessori Martin’s Arm Retractor nuk është i përcaktuar në katalog, me qëllim kjo që Komisionit t’i jepet mundësia për të verifikuar mbi kompatibilitetin e të gjitha pjesëve të përcaktuara në katalog, nëse i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor apo jo dhe nëse përmes tyre do të përmbushëj funksionaliteti i pajisjes apo jo. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke marrë shkas edhe nga pohimi i operatorit ekonomik në seancë dëgjimore, se pavarësisht se aksessori Martin Arm’s retractor nuk është i përcaktuar në katalog kemi pohimin nga prodhuesi “*pra ato na garantojne qe perdorimi i te dyjave bashke me sistemin e fiksimit kranial sherbejne dhe bejne plotesisht detyren e kerkuar nga autoriteti kontraktor per reference optike.*” si një organ *super partes* Komisioni gjykon vetëm mbi bazën e kriterëve të hartuara nga autoritetet kontraktore dhe dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik nga operatorët ekonomikë ankimues. Në këtë kuadër Komisioni nuk mund të gjykojë mbi funksionalitetin e aksesorëve, pra nëse ata e përmbushin apo jo qëllimin duke u bazuar mbi deklaratat, qofshin këto edhe të prodhuesit për aksesorë që së paku nuk janë në katalogun e vetë prodhuesit. Skeda e përputhshmërisë të cilën operatori ekonomik ankimues e ka paraqitur në sistem, është një dokument orientues mbi përmbushjen e kriterit të kërkuar më sipër, e cila i shërben organit vlerësues të ofertave, atij shqyrtues të ankesave, si dhe Komisionit të Prokurimit Publik, për t’u orientuar drejt dhe qartë, se si dhe ku përmbushen specifikimet teknike të kërkuara në katalogun e prodhuesit, por nuk mundet që kurrësi të zëvendësojë përmbajtjen e këtij të fundit, për sa kohë është dokumenti bazë mbi të cilin përmbushet ose jo kriteri i kërkuar.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm *si për fiksuesin kranial te kete referencen optike per neuronavigator ashtu edhe për reference optike kraniale per Neuronavigatorin, perfshire krahun e artikular me montim ne fiksuesin kranial –l cope*” e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-73075-06-20-2023, me objekt: “Loti nr. 4 - Blerje Shtretër operacioni ortopedinë dhe për neurokirurgjinë në SUT”, me fond limit 16,111,333.33 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 08.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

